

**Autorizimi dhe detyrimet e depozituesit të miratuar**

1. Magazinat fiskale janë objekt i mbikëqyrjes dhe kontrollit doganor.
2. Autoritetet doganore miratojnë autorizimin për hapjen dhe shfrytëzimin e një magazine fiskale. Depozituesi i miratuar pajiset me një kod fiskal specifik.
3. Depozituesi i miratuar është i detyruar:
  - a) të japë një garanci, me qëllim që të mbulojë riskun e mundshëm në prodhimin, përpunimin ose mbajtjen e mallrave të akcizës;
  - b) të mbajë për çdo magazinë fiskale regjistrimet dhe kontabilitetin e stokut dhe të lëvizjes së mallrave të akcizës;
  - c) të plotësojë kërkesat e autoriteteve doganore për shkëmbim elektronik të të dhënave;
  - ç) të përmbushë të gjitha kërkesat e vendosura nga administrata doganore, për të mundësuar mbikëqyrjen e magazinës fiskale;
  - d) t'u mundësojë autoriteteve doganore, me kërkesën më të parë, kontrollin mbi mallrat dhe dokumentet;
  - dh) t'u sigurojë autoriteteve doganore ambientet e duhura për zyrën doganore, me pajisjet e nevojshme, si dhe të përballojë shpenzimet për funksionimin e tyre;
  - e) të marrë përsipër shpenzimet për kontrollin e kryera sipas kërkesës së tij jashtë orarit zyrtar të funksionimit të zyrës doganore;
  - ë) të deklarojë llojin e procesit të prodhimit që do të kryejë dhe kartat teknologjike të prodhimit.
4. Mosrespektimi i rregullave të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni sjell si pasojë revokimin e autorizimit.
5. Autorizimi i depozituesit të miratuar pushon së qeni i vlefshëm gjithashtu:
  - a) në rastin e shpërbërjes të një personi juridik;
  - b) kur hiqet dorë vullnetarisht nga autorizimi i depozituesit të miratuar;
  - c) kur autoritetet doganore revokojnë autorizimin.
6. Autoritetet doganore mund të revokojnë një autorizim për depozituesin e miratuar nëse:
  - a) depozituesi i miratuar nuk plotëson më kushtet e vendosura në autorizimin e depozituesit të miratuar ose nuk siguron sistemin e duhur për monitorimin e stokeve, ose kur nuk plotëson listat e stokeve brenda afateve kohore të përcaktuara në autorizimin e depozituesit të miratuar;
  - b) ai nuk depoziton garancinë e llojit të duhur për pagesën e akcizës ose nuk depoziton një garanci në shumën e nevojshme për të paguar akcizën;
  - c) nuk ekzistojnë më kushtet për dhënien e një autorizimi për depozitues të miratuar;
  - ç) autorizimi është lëshuar sipas një informacioni të rremë, të dhënë në keqbesim;
  - d) depozituesi i miratuar nuk ndreq parregullsitë brenda afateve kohore të vendosura nga autoritetet doganore;
  - dh) depozituesi është i përfshirë në veprimtari kriminale;
  - e) depozituesi i shmanget pagesës së akcizës.
  - ë) autorizimi mund të revokohet edhe në raste të tjera kur konstatohen shkelje të dispozitave të këtij ligji.

7. Ankimi, që mund të bëhet ndaj vendimit për revokimin e autorizimit të depozituesit të miratuar, nuk mund të shtyjë zbatimin e vendimit.
8. Kushtet, mënyrat dhe formalitetet për dhënien e autorizimit, sipas pikës 2 të këtij neni, si dhe afatet e vlefshmërisë së autorizimit përcaktohen në aktet nënligjore, në zbatim të këtij ligji.